



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

URDHËR

Nr. 26, datë 8.4.2017

PËR MBLEDHJEN E KUVENDIT
NË SEANCË PLENARE TË DATËS 11.04.2017

Bazuar në nenin 8, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në vendimin e Kuvendit të Shqipërisë nr. 18/2017, datë 16.3.2017 “Për kthimin e dosjeve të kandidatëve që kanë shprehur interesin për të kandiduar për institucionet e rivlerësimit tek Avokati i Popullit për riplotësim të dokumentacionit” dhe në nenin 27, pika 5, të Rregullores së Kuvendit,

URDHËROJ

I. Mbledhjen e Kuvendit në seancë plenare të datës 11.04.2017.

II. Rendi i ditës i seancës plenare është si më poshtë:

1. Projektvendim “Për procedurat parlamentare për funksionimin e komisioneve *ad hoc* dhe realizimin e procesit të votimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

2. Projektvendim “Për krijimin dhe përbërjen e komisionit *ad hoc* për verifikimin e kandidatëve për institucionet e rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

III. Ngarkohen shërbimet e Kuvendit për publikimin e rendit të ditës të seancës plenare, njoftimin e anëtarëve të Kuvendit për datën dhe orën e zhvillimit të seancës plenare, si dhe përgatitjen e dokumentacionit parlamentar që do të shqyrtohet.

IV. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Ilir META

